



STUDIM RRETH

ABDESIT, GUSLIT, TEJEMUMIT,
NAMAZIT

SHEJKH MUHAMED IBËN SALIH EL UTHEJMIN

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Të gjitha falenderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të botëve. Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin e fundit, prijësin e të devotshmëve dhe zotërinë e të gjithë krijesave, profetin tonë Muhamedin, si dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

Dhe më pas:

Thotë robi nevojtar për Mëshirën e Allahut të Lartësuar: Muhamed bin Salih el-Uthejmin: kjo është një broshurë e shkurtër për Abdesin, Guslin dhe Namazin në përputhje me atë që ka ardhur në Kuran dhe në Sunet.

Abdesi:

Abdesi është pastrim i detyrueshëm nga papastërtitë e vogla sikurse është urina, nevoja e madhe, gazrat, gjumi i thellë dhe ngrënia e mishit të devesë.

Mënyra e marrjes së abdesit:

1 – Të bëjë nijet me zemrën e tij për të marrë abdes, duke mos e shqiptuar nijetin me gjuhë sepse Profeti – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – nuk e ka shqiptuar nijetin e tij as për abdes, as për namaz dhe as që e shqiptonte nijetin për adhurimet që bënte, sepse Allahu e di atë që është në zemër kështu që nuk ka nevojë që njeriu ta shqiptojë atë.

2 – Pastaj thotë: BismiLah (Me Emrin e Allahut).

3 – Pastaj: i lan duart deri te kyçi tre herë.

4 – Pastaj: fut ujë në gojë dhe në hundë tre herë.

5 – Pastaj: lan fytyrën tre herë duke filluar nga veshi në vesh për së gjëri dhe nga floku e deri në fund të mjekrës për së gjati.

6 – Pastaj: lan duart e tij tre herë duke filluar nga majat e gishtave e deri te bërrylat. Të parën lan dorën e djathtë, pastaj të majtën.

7 – Pastaj: fshin kokën një herë duke i lagur duart, duke filluar nga balluket e deri në fund të kokës dhe duke i kthyer përsëri te balluket.

8 – Pastaj: fërkon veshët një herë të vetme duke futur gishtat tregues brenda dhe me gishtat e mëdhenj fërkon pjesën e jashtme.

9 – Pastaj: lan këmbët tre herë duke filluar nga majat e gishtave e deri te kyçi i këmbës, të parën lan të djathtën pastaj të majtën.

Gusli:

Gusli është pastrim i detyrueshëm nga papastërtia e madhe sikurse xhunubllëku (kontakti me gruan apo ejakulimi në çdo lloj forme qoftë edhe në ëndërr) dhe menstruacionet.

1 – Të bëjë nijet për gusl me zemër pa e shqiptuar me gjuhë.

2 – Pastaj: thotë BismiLah.

3 – Pastaj: merr abdes të plotë.

4 – Pastaj: hedh ujë mbi kokë derisa të njomet komplet (koka) pastaj derdh mbi të (kokë) tre herë ujë.

5 – Pastaj: lan pjesën tjetër të trupit të tij.

Tejemumi:

Tejemumi është pastrim i detyrueshëm me dhé duke zëvendësuar abdesin ose guslin. Kjo vlen për atë që nuk gjen ujë ose që dëmtohet nga përdorimi i ujit.

Mënyra e Tejemumit:

Të bëjë nijet (me zemrën e tij) për atë që po zëvendëson qoftë abdes apo gusl, pastaj godet tokën ose diçka që është e lidhur me tokën si muret (me pluhur), pastaj fërkon fytyrën dhe duart.

Namazi:

Namazi është adhurim që ka fjalë dhe vepra të cilat fillojnë me tekbir (thënien: Allahu Ekber) dhe mbarojnë me teslijm (thënien: Es-Selamu ‘alejkum ue rahmetUllah).

Nëse dikush dëshiron që të falë namaz, porse ka papastërti të vogël, atëherë ai e ka obligim që të marrë abdes, ndërsa nëse ka papastërti të madhe, atëherë ai e ka obligim që të marrë gusl, ose merr tejemum nëse nuk gjen ujë apo dëmtohet me përdorimin e tij, dhe gjithashtu ai duhet të pastrojë trupin, rrobat e tij dhe vendin në të cilin do të falet nga papastërtitë.

Mënyra e faljes se namazit:

1 – Të drejtohet nga Kibla me të gjithë trupin e tij, pa u devijuar dhe pa u kthyer majtas-djathtas.

2 – Pastaj: bën nijet për namazin që do të falë, me zemër pa e shprehur nijetin me gjuhë.

3 – Pastaj: bën tekbirin fillestar duke thënë “**Allahu Ekber**” dhe gjatë tekbirit i ngre duart drejt me supet e tij.



4 – Pastaj: e vendos pëllëmbën e dorës së djathtë mbi dorën e majtë mbi kraharor.



5 – Pastaj: thotë du'anë hapëse:

Allahumme baa'id bejniy ue bejne khatajaje, kema ba'adte bejnel meshriki uel magribi;

Allahumme nekkiniy min khatajaje, kema junekka eth-theubul abjadu mined-denes;

Allahumme – gsilnij min khatajaje, bith – thelxhi uel maai uel barad.

“O Allah, më largo mua nga gjynahet e mia sikurse e ke larguar lindjen nga perëndimi. O Allah, më pastro mua nga gjynahet e mia sikurse pastrohet rroba e bardhë prej njollave. O Allah, më laj mua prej gjynaheve të mia me borë, me ujë dhe me breshër.”

Ose thotë:

Subhaneke Allahumme ue bihamdike ue tebareke ismuke ue teala xheduke ue la ilahe gajruke.

“I pastër nga çdo e metë je Ti o Allah, Ty të takon lavdërimi, me Emrin Tënd arrihet bereqeti, i Lartësuar je Ti me Madhërinë Tënde, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje”.

6 – Pastaj: i kërkon mbrojtje Allahut duke thënë:

E’udhu bil-lahi minesh-shejtani-rraxhim.

“I kërkoj mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar”.

7 – Pastaj thotë:

“BismiLahi-Rrahmani-Rrahijm” dhe lexon Fatihanë:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾ الرَّحْمَنِ
الرَّحِيمِ ﴿٣﴾ مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾
أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾ صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ
عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

1 - Bismillahir-Rrahmanir-Rrahiim.

(Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit)

2 - Elhamdulillah-lahi Rabbil Aalemiin. (Të gjitha lavdet i takojnë Allahut, Zotit të gjithësisë)

3 - Err-Rrahmaani err-Rrahiim.

(Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit)

4 – Maliki jeumid-diin.

(Sundimtari i Ditës së Gjykimit)

5 - IjjaKe na’budu ue IjjaKe neste’iin.

(Ty të vetëm të adhurojmë dhe Ty të vetëm të kërkojmë ndihmë)

6 - Ihdinas-Siraatal-Mustekiim.

(Na udhëzo në Rrugën e Drejtë)

7 - Siraatal-ledhijne en'amTe 'alejhim, gajril-magduubi 'alejhim ueled-Daal-liin.

(Në Rrugën e atyre të cilët Ti i begatove me mirësi, e jo në rrugën e atyre që morën Zemërimin dhe as në rrugën e atyre që janë të humbur)

Pastaj thotë: **“Amin”** që do të thotë: *“O Allah përgjigju.”*

8 – Pastaj: lexon aq sa i lehtësohet nga Kurani dhe e zgjat leximin në namazin e sabahut.

9 – Pastaj: bie në ruku d.m.th e përkul shpinën e tij si madhërim për Allahun, dhe kur bie për në ruku thotë: **“Allahu Ekber”** duke i ngritur duart e tij drejt me supet. Suneti është që (në ruku) ta drejtojë shpinën e tendosur dhe ta drejtojë kokën në një linjë me shpinën, si dhe ti vendosë duart mbi gjunjë me gishtat e hapur.



10 – Në ruku thotë:

Subhane Rabbijel 'Adhijm

“I pastër dhe i lartësuar nga të metat është Zoti im i Madhëruar” (këtë e thua) tre herë, dhe nëse shton:

Subhaneke Allahumme Rabbena ue bihamdiKe Allahumme gfirli.

“I pastër dhe i lartësuar nga të metat je Ti o Allah! O Allah më fal mua” kjo është gjë e mirë.

11 – Pastaj: e ngre kokën nga rukuja duke thënë:

Semi' Allahu limen hamideh.

“Allahu i përgjigjet lavdëruesit” dhe i ngre duart drejt me supet. Ndërsa ai që falet me imam nuk thotë **Semi' Allahu limen hamideh.**

Por thotë: **Rabbena ue lekel hamd.** “O Zoti ynë Ty të takon falenderimi dhe lavdërimi”.

12 – Pastaj pasi ngrihet thotë:

Rabbena ue lekel hamd, mil'es-semauati ue mil'el-erd, ue mil'e ma shi'te min shej'in ba'd

“O Zoti ynë, Ty të takon falenderimi dhe lavdërimi i cili mbush qiejt dhe tokën, si dhe mbush atë që Ti krijon pas tyre.”

13 – Pastaj: bie në sexhden e parë duke iu nënshtruar dhe duke iu përrulur Allahut.

Kur bie për në sexhde thotë: “**Allahu Ekber**” dhe e kryen sexhden me shtatë gjymtyrët e tij, të cilat janë: balli me hundën, dy pëllëmbët, dy gjunjët dhe majat e këmbëve, duke i larguar krahët nga brinjët, dhe duke mos i shtrirë parakrahët e tij në tokë, ndërsa majat e gishtave i drejton nga kibla.



Sexhdeja



Mbajtja e këmbëve në Sexhde

14 – Dhe thotë në sexhde:

Subhane Rabbijel E'ala

“I pastër nga të metat është Zoti im i Lartësuar” tre herë, e nëse shton:

Subhaneke Allahumme Rabbena ue bihamdike, Allahumme gfirli.

“I pastër dhe i lartësuar nga të metat je Ti o Allah! O Allah më fal mua” atëherë kjo është gjë e mirë.



15 – Pastaj: e ngre kokën nga sexhdeja duke thënë: **“Allahu Ekber”**.

16 – Pastaj: ulet midis dy sexhdeve mbi këmbën e tij të majtë, ndërsa këmbën e djathtë e vendos në pozicion pingul me thembër lart e me gishta përdhe të përthyer drejt kiblës, dhe e vendos dorën e tij të djathtë në fund të kofshës së djathtë nga ana e gjurit, “duke e mbledhur gishtin e fundit dhe të parafundit ndërsa gishtin tregues e ngre dhe e lëviz gjatë lutjes pasi e ka bashkuar majën e gishtit të madh me majën e gishtit të mesëm në formë rrethi,” dhe e vendos dorën e majtë me gishta të hapur mbi fundin e kofshës së majtë nga ana e gjurit.



17 – Dhe thotë në uljen ndërmjet dy sexhdeve:

Allahumme gfirli, uerhamni, uehdini, uerzukni, uexhburni, ue afini.

“O Allah më fal, më mëshiro, më udhëzo, më furnizo, më ndihmo dhe më shëro”.

18 – Pastaj: bie për në sexhden e dytë me përrulje dhe me nënshtrim ndaj Allahut, dhe vepron ashtu sikurse veproi në sexhden e parë, si në fjalë ashtu edhe në vepra, dhe bën tekbir **“Allahu Ekber”** kur bie për në sexhde.

19 – Pastaj: ngrihet nga sexhdeja e dytë duke thënë: **“Allahu Ekber”** dhe fal rekatën e dytë njësoj si rekatën e parë në të gjitha veprimet përveç duasë hapëse e cila nuk thuhet (përveç se në rekatën e parë).

20 – Pastaj: pas përfundimit të rekatit të dytë ulet duke thënë: **“Allahu Ekber”** pra ulet njësoj siç u ul midis dy sexhdeve.

21 – Dhe lexon teshehudin duke thënë:

Ettehijjatu lil-lahi ues-salauaatu uet-tajjibatu, esselaamu ‘alejke ejjuhen-Nebiju ue rahmetullahi ue berekaatuhu, esselaamu ‘alejna ue ‘ala ibaadillahis-salihijn, esh-hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh-hedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu.

“Madhërimet, namazet, fjalët dhe punët e mira, janë vetëm për Allahun. Lavdërimi dhe shpëtimi Allahut qofshin për ty o i dërguari i Allahut. Paqja, bekimi dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ty o i Dërguar (i Allahut), paqja qoftë edhe mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të Allahut. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij.”

Pastaj thotë: **Allahumme sal-li ala Muhammedin, ue ‘ala Aali Muhammed, kema salejte ala Ibrahimie ue ‘ala Aali Ibrahimie, inneke hamijdun mexhijd, Ue baarik ‘ala Muhammed, ue ‘ala Aali Muhammed, kema baarekte ‘ala Ibrahimie ue ‘ala Aali Ibrahimie, inneke hamijdun mexhijd.**

“O Allah, lavdëroje Muhamedin dhe familjen e tij te melaiket, ashtu siç e lavdërove Ibrahimin dhe familjen e tij, padyshim që Ti je i Madhëruar dhe i Lavdëruar, dhe

bekoje Muhamedin dhe familjen e tij sikurse e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, padyshim që Ti je i Madhëruar e i Lavdëruar.”

Pastaj thotë: **Allahumme innij e‘udhu bike min ‘adhaabil kabri ue min ‘adhaabi xhehennem, ue min fitnetil mahja uel memaati, ue min sherri fitneti mesijhid-dexhaal.**

“I kërkoj Allahut të më mbrojë nga dënimi i Xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga çdo gjë që më dëmton në fenë, trupin dhe dunjanë time, nga tmerret e vdekjes, dhe nga sprova e Mesihut Dexhal.”

Pastaj: i lutet Zotit të tij për çfarë të dëshirojë prej mirësive të dunjasë dhe ahiretit.

22 – Pastaj: jep selam nga e djathta e tij duke thënë: **“Es-Selamu alejkum ue rahmetuLlah”**. Njëjtë vepron edhe nga e majta.

23 – Nëse namazi është me tre rekate apo me katër atëherë ai ndalon (hesht) në fund të teshehudit të parë, pra te fjala:

Esh-hedu en la ilahe il-lAllah, ue esh-hedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu.

“Unë dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i dhe i dërguari i Tij”.

24 – Pastaj ngrihet në këmbë duke thënë: **“Allahu Ekber”** dhe atëherë i ngre duart drejt me supet.

25 – Pastaj: e fal pjesën e mbetur të namazit të tij sipas mënyrës së rekatit të dytë, porse në rekatit të tretë apo të katërt ai mjaftohet vetëm me leximin e Sures El-Fatiha.

26 – Pastaj: ulet duke vendosur vithet në tokë, dhe këmbën e djathtë e vendos në pozicion pingul, ndërsa shputën e këmbës së majtë e vendos nën kërcirin e këmbës së djathtë, e më pas akomodohet mirë dhe i vendos duart mbi kofshët e tij njësoj siç veprimi në teshehudin e parë.



**Vendosja e shputës
së majtë nën këmbën
e djathtë në
Teshehudin e fundit**

27 – Në këtë ulje e lexon të gjithë teshehudin.

28 – Pastaj: jep selam nga ana e djathtë duke thënë: “**Es-Selamu alejkum ue rahmetullah**” edhe nga e majta vepron njëjtë.

Gjërat e urryera në namaz:

1 – Është e urryer në namaz kthimi i kokës apo i shikimit, ndërsa drejtimi i shikimit nga qielli është haram.

2 – Është e urryer në namaz marrja me gjëra të padobishme si dhe lëvizja pa nevojë.

3 – Është e urryer që të merret me vete diçka që të angazhon si për shembull diçka e rëndë apo me ngjyra që të tërheq vëmendjen.

4 – Është e urryer në namaz vendosja e duarve në ije.

Gjërat që e prishin namazin:

1 – Priset namazi nëse flet me qëllim edhe nëse flet pak.

2 – Priset namazi nëse devijon nga kibla me të gjithë trupin.

3 – Priset namazi nga dalja e erës nga anusi, dhe me çdo gjë e cila obligon abdesin apo guslin.

4 – Priset namazi me lëvizje të shumta e të njëpasnjëshme duke mos qenë të domosdoshme.

5 – Priset namazi nëse qesh edhe nëse është e pakët.

6 – Priset namazi nëse shton një ruku apo një sexhde apo një kijam apo një ulje qëllimisht.

7 – Priset namazi nëse i paraprin imamet qëllimisht.

Shënim i përkthyesit: Të gjitha fotot janë vënë nga përkthyesi, për tu kuptuar sa më lehtë pasi kjo është broshurë për fillestarë

Përktheu: Muhamed Kallashi

Titulli origjinal i librit: رسالة في الوضوء والغسل والصلاة

Titulli në shqip: Broshurë rreth Abdesit, Guslit, Tejemumit, Namazit.

Autor: Shejkh Muhamed ibn Salih el-Uthejmin

Përkthyesi: Muhamed Kallashi

Botuesi: www.selefi.org

Mail: radioselefi@gmail.com

Copyright © 2019

Çdo e drejtë e përshtatjes dhe e riprodhimit të këtij botimi, në çfarëdo lloj mënyre, është e ndaluar pa lejen e qartë dhe paraprake të botuesit www.selefi.org